



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-16-0117

N.P. Prizren.

Ankuesi/paditësi

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr“ Agim Ramadani” nr.23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të gjyqtarit të vetëm me kompetenca te deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-2514 të datës 13 maj 2016, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit, refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet, Aktgjykimi i gjyqtarit të vetëm me kompetenca te deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-2514 të datës 13 maj 2016.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedural

Më 22 tetor 2013, ankuesi në DHPGJS në Prishtinë, ka parashtruar ankesë kundër Vendimit nr.PRZ041-0181 i datës 25.09.2013, lëshuar nga AKP-Autoriteti i Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore "L" (në likuidim, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e 3 pagave të pa paguara në shumën prej 672.00 euro. Nga DHPGJS ka kërkuar që Ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe të shfuqizohet Vendimi i atakuar e atij ti njihet e drejta në kompensimin e pagave të pa paguara.

Në mbrojtjen e parashtruar ndaj kësaj ankesë më datë 02 korrik 2014 e paditura, AKP i propozoi Gjykatës refuzimin e ankesës si të pabazuar dhe vërtetimin e vendimit të ankimuar të autoritetit të likuidimit,(më tutje AL) duke theksuar se kërkesa e ankuesit është parashkruar, sipas nenit 608 të Ligjit Punën e Bashkuar. Sipas këtij neni kërkesat për pagat e papaguara parashkruhen brenda 3 viteve ngase ankuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjore për të kërkuar pagat e tij brenda afatit të parashkrimit, një kërkesë e tillë ka mund të parashtrohej nga muaji shtator 1999 kur sipas ankuesit NSH-ja e ka ndërprerë pagesën e pagave të tij. Andaj DHPGJS i ka propozuar që këtë Ankesë ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Ankuesi në përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes së të paditurisë, më datë 29 korrik 2014, ka mbetur sipas pretendimeve të parashtruara në ankesë mbetet pranë kërkesës së tij për kompensimin e pagave të papaguara, duke theksuar se i takon një e drejtë e tillë dhe për këtë i plotëson kushtet e parapara ligjore. Andaj i propozon Gjykatës që Ankesa e aprovohet si e bazuar.

E paditura në kundërpërgjigjen ndaj përgjegjës së Ankuesit me datë 04 shtator 2014, gjithashtu sikurse edhe në mbrojtjen e parashtruar më herët i ka propozuar Gjykatës që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 13 maj 2016, gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS me Aktvendimin C-IV-13-2514, ankesën e paditësit e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Vendimin e AL nr. PRZ041-0181 të datës 25.09.2013 me arsyetim se kërkesa ishte parashkruar. Paditësi nuk ka specifikuar periudhën përkatëse kohore të pagave të pa paguara si dhe nuk ka arritur të vërtetoj me asnjë provë të besueshme se për realizimin e të drejtave të veta i është drejtuar ndonjë organi apo gjykate kompetente para fillimit të procedurës së likuidimit. Kolegji i Specializuar arsyetoi se vendimi i AL sqaron se në baze të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (G. Zyrtare nr. 53/76 i aplikueshëm) përcaktohet se 'Pagesat e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jete e parashkruar në afatin prej 3 viteve.

Nisur nga këto gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar ka refuzuar ankesën si të pa bazuar dhe ka vërtetuar Vendimin e AL.

Më 31maj 2016, paditësi ka paraqitur Ankesë kundër Aktgjykimit, C-IV-13 -2514 të datës 13 05 2016(me tutje aktgjykimi i ankimuar) për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Ankuesi pohon se Kolegji i Specializuar gabimisht zbaton Ligjin e Punës së Bashkuar i cili me 1988 është shfuqizuar me Ligjin mbi Ndërmarrjen. Për më tepër Kolegji i Specializuar injoron edhe faktin se po kjo Gjykatë i njeh të drejtën në shpërblim të 20% nga privatizimi në lëndën C-IV-0045 të dt. 10/05/2013. Nisur nga të lartcekurat kërkoi nga Kolegji i Apelit që të aprovoj Ankesën si të bazuar dhe të vendosë meritorisht mbi çështjen në fjalë.

Më 22 qershor 2016, pala e paditura pohuara se qëndrimi i saj lidhur me Ankesën është qartësisht dhe mjaftueshëm i sqaruar në Mbrojtje dhe në Kundërpërgjigjen e parashtruar pranë Kolegjit të Specializuar dhe e përsëritja e argumenteve i konsideron të padobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP i propozon Kolegjit të Apelit të refuzojë Apelin si të pabazuar dhe vërtetoj Aktgjykimin e Kolegjit të specializuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet të vërtetohet.

Më 16 korrik 2013 ankuesi ka parashtruar kërkesë para AL për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 627.00 euro për periudhën e pa caktuar.

Sipas nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (më tutje LPB) kërkesa monetare sikur janë pagat, parashkruhen brenda 3 vitesh dhe afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga dita kur NSH-ja kishte ndërprerë pagesën e pagës.

Neni 196 i Ligji mbi Ndërmarrjet ka shfuqizuar LPB me përjashtim të kapitullit të – IV- i cili mbeti në fuqi dhe i cili ishte në fuqi deri më hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-2012 i cili me nenin 99 shfuqizon LPB.

Ligji i Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-2012 nuk e rregullon materien e parashkrimit të borxhit që rrjedhin si rezultat i marrëdhënies së punës. Në këtë rast mund të zbatohen, Rregullat e përgjithshme të parashkrimit, të përcaktuara në Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore nr./30 mars 1978 (më tutje LMD) (i zbatueshëm), kërkesat monetare peridike parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.

Ankuesi si provë ka parashtruar vetëm librezën e punës e mbyllur më 28/09/1999 nuk ka parashtruar prova tjetër me përjashtim të kërkesës para AL datës 16 korrik 2013 për kompozimin e pagave të pa paguara me të cilat provohet se ka ndërprere rrjedhën e parashkrimit të kërkesës së tij. Nuk ka asnjë provë me të cilën vërtetohet ndërmarrja e ndonjë iniciative për kompensimin e pagave të pa paguara në një periudhë tjetër kohore apo para një organi tjetër kompetent apo gjykate.

Kolegji i Apelit e konsideron si moment të ndërprerjes së pagesës, 3 vite nga momenti i mbylljes së librezës së punës fillon të rrjedh parashkrimi. Ky moment sipas Kolegjit të Apelit në mungesë të provave tjera, duhet të jetë momenti i supozuar mbylljes së librezës së punës 28/09/1999.

Kolegji i Apelit e konsideron si të parashkruar kërkesën e ankuesit për kompensimin e pagave të pa paguara .

Sipas nenit 361 të LMD-së afati fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Kolegji i Apelit konkludon se afati ka filluar të rrjedhë nga i vitit 1999, paga e fundit e pa paguar.

Ankuesi nuk ka parashtruar asnjë provë me të cilën vërtetonte ndërmarrjen e ndonjë iniciative për kompensimin e pagave të pa paguara para një organi kompetent apo gjykatë.

Nga ndërprerjen e supozuar vitit 1999 deri në momentin e parashtrimit të kërkesës para AL ndërprerja parashkrimit kanë kaluar më shumë se 3 vite, kërkesa tashmë ishte parashkruar.

Nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe duhet të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi nuk ngarkohet me taksë Gjyqësore. Sipas udhëzimit administrativ nr/01/2017 kërkesat nga marrëdhënia e punës me vlerë nën 1.000 euro nuk ngarkohen me taksë gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 26 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtari Kryesues _____

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIT

Ju lutem të dorëzoni këtë Aktgjykim tek:

- Palët
- Gjyqtarit të vetë me kompetenca të deleguaratë Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën C-IV.-13-2514.

Ilmi Bajrami, Gjyqtari Kryesues
